



KONFERENCA E REKTORËVE E UNIVERSITETEVE PUBLIKE TË KOSOVËS

KOMUNIKATË PËR PROCESIN E RI/AKREDITIMIT 2021

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 12.02.2021 diskutoi për mbarëvajtjen e procesit të ri/akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe të programeve studimore.

Konferenca e Rektorëve shpreh shqetësimin e vet për gjendjen e krijuar në KSHC pas dorëheqjeve së dy anëtarëve vendorë, duke vlerësuar se këto dorëheqje në këtë situatë zgjedhore e dëmtojnë procesin e ri/akreditimit dhe procesin e rikthimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim në ENQA dhe EQAR.

Konferenca e Rektorëve inkurajon KSHC-në dhe Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Akreditim që, sa më parë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit e të Shkencës të gjejnë zgjidhjen e duhur sa më shpejt për të dalë nga situata e krijuar e bllokimit të KSHC-së.

Konferenca e Rektorëve shprehet e gatshme të ofrojë tërë përkrahjen e duhur për konsolidimin dhe rifillimin e punës së KSHC-së dhe rikthimit në ENQA dhe në EQUAR.

Kryesues i Konferencës së Rektorëve

Prof. Dr. Bajram Kosumi,
Rektor i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan

Prishtinë, më 13.02.2021